



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 060/01-1738/26
Kaçanik, 30.01.2026

Në bazë të nenit 12.2 pika (d) lidhur me nenin 17 pika (i) dhe 40.2 pika (l) të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/04. Qershor 2008) të nenit 6.2 lidhur me nenin 34.5 të Statutit Komunës, së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe Ndryshim Plotësimit të Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, të Propozim Deklaratës mbështetëse të Kryetarit Komunës Kaçanik 01Nr. 060/01-1738/26, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 30 janar 2026, vendosi të nxjerrë këtë:

DEKLARATË MBËSHTETËSE

1. Kuvendi i Komunës së Kaçanikut shpreh mbështetjen e plotë për Deklaratën për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike, e cila është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19 nëntor 2024 dhe e nënshkruar nga 66 deputetë të Legjislaturës së VIII.
2. Kuvendi i Komunës së Kaçanik mbështet gjithashtu Komunikatën Mbështetëse të datës 14 korrik 2025, të nënshkruar nga anëtarë të kuvendeve komunale në nivel rajonal, përfaqësues të shoqërisë civile dhe institucioneve të tjera publike, në kuadër të takimit të organizuar nga Misioni i OSBE-së, të mbajtur në Gjilan.
3. Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut angazhohet për forcimin e bashkëpunimit institucional dhe shoqëror me qëllim parandalimin dhe eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike.
4. Kuvendi i Komunës së Kaçanikut obligon strukturat përkatëse komunale, përfshirë Kryesuesin e Kuvendit Komunal, Kryetarin e Komunës dhe Zyrën për Barazi Gjinore, që të promovojnë Deklaratën dhe parimet e saj përmes aktiviteteve informuese, komunikimit publik dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe partnerët relevant.
5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Kaçanikut.
Me këtë vendim njoftohet: MAPL, Kryetari i Komunës (përmes Zyrës së Kryetarit njoftohen mekanizmat tjerë relevantë), Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Selajdin Troni



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 060/01-1738/26
Kaçanik, 19.01.2026

Në bazë të nenit 12.2 pika (d) lidhur me nenin 17 pika (i) dhe 40.2 pika (l) të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/04. Qershor 2008) të nenit 6.2 lidhur me nenin 34.5 të Statutit Komunës, së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshim plotësimit të Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020 Kryetari i Komunës Kaçanik,

PROPOZON

Që Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me _____/2026, të aprovoj këtë:

DEKLARATË MBËSHTETËSE

1. Kuvendi i Komunës së Kaçanikut shpreh mbështetjen e plotë për Deklaratën për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike, e cila është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19 nëntor 2024 dhe e nënshkruar nga 66 deputetë të Legjislaturës së VIII.
2. Kuvendi i Komunës së Kaçanik mbështet gjithashtu Komunikatën Mbështetëse të datës 14 korrik 2025, të nënshkruar nga anëtarë të kuvendeve komunale në nivel rajonal, përfaqësues të shoqërisë civile dhe institucioneve të tjera publike, në kuadër të takimit të organizuar nga Misioni i OSBE-së, të mbajtur në Gjilan.
3. Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut angazhohet për forcimin e bashkëpunimit institucional dhe shoqëror me qëllim parandalimin dhe eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike.
4. Kuvendi i Komunës së Kaçanikut obligon strukturat përkatëse komunale, përfshirë Kryesuesin e Kuvendit Komunal, Kryetarin e Komunës dhe Zyrën për Barazi Gjinore, që të promovojnë Deklaratën dhe parimet e saj përmes aktiviteteve informuese, komunikimit publik dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe partnerët relevant.
5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Kaçanikut.

Me këtë vendim njoftohet: MAPL, Kryetari i Komunës (përmes Zyrës së Kryetarit njoftohen mekanizmat tjerë relevantë), Arkivi.



Kryetari i Komunës
Sabedin Vishi